



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

Departamenti i Administratës Qendrore/Departament Centralne Administracije

Department of Central Administration

Divizioni i personelit / Divizija personela / Personnel division

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/01, Procedurat e rekrutimit, në gazetën “Infopress”, “Zëri”, “Radio blue-sky” dhe në ueb faqen e MPB është publikuar konkursi për plotësimin e vendit të punës **Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës**, me datën 31.08.2010. Afati i fundit për aplikim ka qenë 14.09.2010.

Në atë konkurs, deri në ditën e skadimit të tij, nuk është paraqitur numër i mjaftueshëm i kandidatëve për ta bërë përzgjedhjen e tyre sipas kualifikimeve të kërkuara, strukturës gjinore dhe asaj etnike.

Në harmoni me pikën 5d të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/01 MPB:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIT

Titulli i postit: Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Afati për paraqitjen e aplikacioneve: Pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Të gjitha kushtet tjera mbeten të njëjta sikur në konkursin e parë.

Kandidatët të cilët kanë konkurruar në atë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri!

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen te z. Ragip Ramadani në Sekretarin e KELDP-së në zyrën Nr.401 objekti i MPB në rrugën Luan Haradinaj (afër stadiumit të Prishtinës), ose të shkarkohen nga ueb faqja e MPB në adresën WWW.mpb-ks.org.

Afati i aplikimit është 15 ditë nga dita e vazhdimit të konkursit, në ndonjërin nga gazetaret ditore dhe në mjetet e komunikimit elektronik gjegjësisht deri me datën **30.09.2010 në ora 16:00**.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: kopjet i letërnjoftimit dhe të dokumentacionit të kërkuar lidhur me kualifikimet dhe përvojën e punës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, nga personeli.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për shikim (konfirmim) të gjitha dokumentet origjinale.

Për çdo informatë mund ta kontaktoni z. Ragip Ramadani në tel. nr. 038-212-088 lokal 19-654; mob. 044 211 278 nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet!

Ministria e Punëve të Brendshme i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ajo i mirëpret aplikacionet prej femrave dhe meshkujve, dhe pa dyshim, inkurajon të gjitha grupet etnike minoritare në Kosovë.